

ZYMER UJKAN NEZIRI

DEMONSTRATAT E VITIT 1968 NË KOSOVË, MAQEDONI E MAL TË ZI DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE SHQIPTARE

Hyrje

Viti 1968, me kërkesat kryesore për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje, që u bë pjesë e rëndësishme e historisë sonë më të re,¹ lidhet edhe me kohën e Kongresit të Berlinit (1878), kur Fuqitë e Mëdha e copëtuan Shqipërinë, të pushtuar nga Perandoria Osmane, më 1479,² dhe heshtën për masakrimin e banorëve të sanxhakut të Nishit nga Serbia dhe për shpërnguljet e tyre të dhunshme në drejtim të Rrafshit të Kosovës.³ Krimi i Fuqive të Mëdha vazhdoi me heshtjen edhe ndaj masakrave të vendeve fqinje në viset shqiptare, më 1912, dhe me miratimin e atyre pushtimeve në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913, kur Greqia u zgjerua 2,7 herë, Mali i Zi 3 herë dhe Serbia 2,8 herë, me zgjerim mbi Vojvodinën në Konferencën e Versajës, 1919.⁴ Sot, Republika e Kosovës ka vetëm një pjesë të vogël të territorit

¹ Burimet e citimeve plotësuese janë mbështetur kryesisht nga kumtesat e organizuesve të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, mbajtur më 2008, të botuara në librin: *Demonstratat e vitit 1968*, Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore, mbajtur me rastin e 40-vjetorit në Prishtinë, më 24-25 nëntor 2008, vëll. I, II, përgatitja për shtyp Zymer U. Neziri, Meriman Braha, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2018.

² Shqipëria e pushtuar nga osmanët, më 1479, dhe viset e tjera europiane të pushtuara prej tyre ishin të ndara në vilajete. Perandoria e tyre kishte në Europë katër vilajete, me ndryshime jo të mëdha, deri më 1839: vilajeti i Rumelisë, i Temishvarit, i Budimit, i Bosnjës. Shih: Liman Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2004, f. 13. Kosova, apo Dardania e vjetër, si pjesë e Shqipërisë, deri më 1912, kishte një territor shumë më të madh se ky i sotmi.

³ Hakif Bajrami, *Politika serbe për rikolonizimin e Kosovës me sllavë 1945-1948*, Prishtinë: Era, 2002, f. 619. Në vitet 1878-1879 kemi zbrazjen e 714 katundeve shqiptare dhe 350 mijë të shpërngulur.

⁴ “Memorandumi për çështjen shqiptare” i Forumit të Intelektualëve Shqiptarë, Prishtinë, dërguar ministrave të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, të Francës, të Gjermanisë, të Rusisë, të ShBA-ve etj., më 26 tetor 1995, në *Çështja kombëtare dhe*

të vilajetit të Kosovës⁵ dhe bashkë me Republikën e Shqipërisë kanë vetëm afërsisht gjysmën e viseve shqiptare. Edhe pas vitit 1912, shqiptarët kërkuan e luftuan për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të pushtuara dhe për bashkimin e tyre me Shqipërinë. Përpjekje ka pasur edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore⁶ dhe pas saj.

Kosova pas pushtimit më 1912 dhe shfarosja e shqiptarëve

Viti 1968, me kërkesat kryesore për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje, për viset shqiptare nën Jugosllavi, sollti ndërmend edhe kohën kur Kosova u pushtua tërësisht më 1912 nga Serbia e Mali i Zi dhe t'i kujtonte krimet e tyre dhe gjenocidin për shfarosjen e shqiptarëve. Sipas Leon Trockit, Mbreti Petar I Karagjorgjeviq, më 1912, pas Betejës së Kumanovës, për robërit shqiptarë, kishte thënë: “duhet t'i mbysni, jo me pushkatim, sepse kjo do të jetë humbje e municionit, por me shpatë.”⁷ Edhe Hasan Prishtina shkruan për krimet e tyre, se ata “vranë, prenë e dogjën 30 000 shqiptarë, sidomos fëmi të njomë e gra të pafaje.”⁸ Ashtu

vetëdija kritike, redaksia: Masar Stavileci, Agim Vinca, Abdyl Kadolli, Zymer Neziri, Forumi i Intelektualëve Shqiptarë, Prishtinë: 1998, f. 149.

⁵ Kosova kishte statusin e vilajetit nga viti 1868 dhe përbëhej nga katër sanxhakë: sanxhaku i Prizrenit, i Shkupit, i Dibrës dhe i Nishit. Tri vilajetet e tjera shqiptare ishin formuar më 1864: vilajeti i Shkodrës, i Manastirit, i Janinës dhe i Kosovës, 20 vjet më vonë, më 1888, kishte 6 sanxhakë: sanxhaku i Shkupit, i Prishtinës, i Prizrenit, i Pejës, i Pazarit të Ri dhe Taslixhes (Plevles). Shih: L. Rushiti, *Ndarja territoriale ...*, f. 13-14.

⁶ Në Konferencën e Bujanit, më 31 dhjetor 1943-2 janar 1944, ku kishte edhe përfaqësues sllavë, u vendos në Rezolutë dëshira e popullit shqiptar “me u bashkue me Shqipni”. Pra, aty thuhej se, pas luftës së përbashkët, do të ketë “vetëvendosje deri në shkëputje”, kurse dorëzanë janë ushtria shqiptare dhe ajo jugosllave. Por, në vend të kësaj ndodhi ripushtimi jugosllav. Shih *Konferenca e Bujanit* (Materiale nga sesioni shkencor kushtuar 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë, më 7 janar 1994), redaktor përgjegjës Fehmi Rexhepi, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1998, f. 179, 182, 183; më gjerësisht, *po aty* shih: Zekeria Cana, “Mbledhja e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe çështja e bashkimit kombëtar”, f. 72-79.

⁷ Leon Trocki, *The Balkan Wars*, Monad, New York: 1980, f. 290, cituar sipas L. Rushiti, *Ndarja territoriale ...*, f. 67.

⁸ Tahir Abdyl, “Hasan Prishtina (Në 55-vjetorin e vrasjes së Hasan Prishtinës 1933-1988)”, në revistën *Kosova*, nr. 17, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1988, f. 93. Hasan Prishtina, duke shkruar për Esatin dhe për miqësinë e tij me Serbinë, përmend shifrën e krimeve serbe pas pushtimit, më 1912 - 30 mijë shqiptarë: “Njata vetë janë qi përpara pesë vjetëve vranë, prenë e dogjën 30 000 shqiptarë, sidomos fëmi të njomë e gra

ishite edhe pas ripushtimit, më 1919. Ali Hadri thoshte se Nikolla Pashiq, Kryeministër jugosllav, mendonte se për 20-25 vjet do të asimilonte këtë popullatë në aspektin nacional e kulturor.⁹

Xhelal Gjeçovi shkruan se gjatë reformës agrare 1918-1941, shqiptarëve ua shpronësuan 381 mijë ha tokë, e vetëm në Kosovë 200 mijë ha. Dëbuan me forcë nga vatrata e tyre 250 mijë shqiptarë, shumica e të cilëve u vendosën në Turqi, e pak në Shqipëri. Në tokat e tyre sollën 14 mijë familje kolonësh sllavë me 60-70 mijë kolonë.¹⁰ Gjendja ishte e njëjtë edhe pas ripushtimit vijues, më 1945. Hakif Bajrami shkruan se synohej nga ana e pushtetit serbomadhe të zbatohesh serbizimi i përgjithshëm i popullsisë shqiptare.¹¹ Por, nga viti 1912, Serbia dhe Jugosllavia, mbretërore e komuniste, kanë shpronësuar e kanë kolonizuar 381 245 hektarë tokë të shqiptarëve me rreth 150 mijë serbë e malazezë, e në vitet '90 edhe me mbi 20 mijë kolonë serbë nga Kroacia.¹²

J. B. Tito i Jugosllavisë II vazhdoi aty ku kishin mbetur Petri i Parë dhe Nikolla Pashiqi të Jugosllavisë I. Pas aneksimit, në shkurt 1945, në Kosovë u vendos pushteti ushtarak. Aneksimi u bë në prill 1945 nga Këshilli Antifashist i Serbisë dhe u miratua në gusht 1945 nga Këshilli Antifashist i Jugosllavisë, me status autonom në kuadër të Serbisë, pa të drejtë gjuhe në administratë, pa flamur etj.¹³ Në fillim të viteve '50, J. B. Tito e riaktivizoi Konventën e vitit 1938 me Turqinë dhe deri në gjysmën e dytë të viteve '60 u dëbuan rreth 500 mijë shqiptarë nga Kosova.¹⁴ Ndërkaq, nga Luftërat Ballkanike e deri më 1999, Serbia dhe Jugosllavia, e periudhës mbretërore dhe e asaj komuniste, kanë vazhduar gjenocidin mbi shqiptarët etnikë, duke vrarë me mijëra veta, duke shpërnguluar për

të pafaje”, cituar sipas artikullit të Hasan Prishtinës, “Esat Toptani e Italicjanët”, në *Vëllaznija*, nr. 79, Vjenë, 26 tetor 1917.

⁹ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë: Rilindja, 1971, f. 27, cituar sipas: Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1981, f. 51.

¹⁰ Xhelal Gjeçovi, “Kosova, 3. Vështrim historik”, në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II (H-M), botim i ri, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 1297.

¹¹ H. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë...*, f. 348.

¹² Shih “Memorandumi për çështjen shqiptare ...” f. 150.

¹³ Xh. Gjeçovi, “Kosova, 3. Vështrim historik ...”, f. 1299.

¹⁴ Po aty.

Turqi rreth një milion shqiptarë,¹⁵ por Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk u ndal.

Kosova - Republikë dhe Vetëvendosja

Demonstratën e parë në Kosovë dhe në viset e ripushtuara nga jugosllavët, për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje e organizoi dhe e realizoi grupi i studentëve atdhetarë të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prizren, më 6 tetor 1968.¹⁶ Ky grup, në krye me studentin Meriman Braha dhe vëllezërit Mikel e Simon Kuzhnini, ishte bërthama e organizimit të demonstratave në tërë Rrafshin e Dukagjinit, në tri qendra, në Prizren, më 6 tetor,¹⁷ në Therandë (Suharekë), më 8 tetor,¹⁸ dhe në Pejë,¹⁹ më 19

¹⁵ Shih: “Memorandumi për çështjen shqiptare...”, f.150.

¹⁶ Grupi i studentëve të Prizrenit, në krye me Meriman Brahën, e kishte organizuar këtë demonstratë edhe më 10 qershor 1968, por ajo nuk u realizua, sepse u diktua nga organet e sigurimit shtetëror. U vendos për datën 6 tetor, që nuk ishte datë historike. Ky grup i studentëve të Prizrenit, pos Merimanit, Isa Demajt, Rafet Ramës, Zymer Nezirit etj., ishte arrestuar edhe më parë, ditën e Flamurit, më 28 Nëntor 1967, dhe kishte qenë nën hetime edhe pas lirimit nga burgu i Prizrenit, gjatë pranverës së vitit 1968.

¹⁷ Në organizimin e Demonstratës së Prizrenit, më 6 tetor 1968, sipas Meriman Brahës, u dalluan edhe Pashk Laçi e Gjergj Camaj, si dhe studentë të tjerë, djem e vajza: Lemane Braha, Shpresa Elshani, Shyhrete Tahiri, Drita Krasniqi, Drita Xharra, Isa Demaj, Rafet Rama, Binak Ulaj, Haxhi Bajraktari, Haxhi Maloku, Xhafer Kabashi, Vahid Kabashi, Liman Kabashi, Kujtim Xharra, Afrim Dushi, vëllezërit Malazogu, Shaban Gjekaj, Ali Galica, Ruzhdi Kadriu, Hilmi Gashi, Ilaz Nallbani, Ilir Berisha, si dhe Zymer Neziri, hartues i fjalimeve të Demonstratës së Prizrenit, të miratuara nga Grupi i Prizrenit 1968. Ato i lexuan në sheshin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Pashk Laçi, në emër të banorëve të Prizrenit me rrethina, e Gjergj Camaj, në emër të studentëve të Shkollës së Lartë Pedagogjike. Sipas Meriman Brahës, aty u vendos kurora e 10 qershorit të atij viti, e blerë nga Pashk Laçi, kur edhe ishte planifikuar demonstrata e 6 tetorit, por që nuk ishte mbajtur për shkak të rrethanave të krijuara. Kurorën e kishte ruajtur atdhetari i njohur Hasan Rrema. Flamuri kombëtar, i ndaluar me ligj, i qepur nga Kujtim Xharra, krahas këngëve atdhetare, që shumë prej tyre ishin po ashtu të ndaluara, të cilave u printe studenti Shaban Gjekaj, dhe kërkesave për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje, solli emocione të jashtëzakonshme dhe lot. Brohoritjet edhe për flamurin kuqezi, popullin shqiptar e Shqipërinë, për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për Abdyl Frashërin e Ymer Prizrenin, për Bajram Currin e Hasan Prishtinën etj., jehonin deri në Kala dhe në katër anët e qytetit. Shumë herë janë përsëritur edhe vargjet e këngës së përshtatur: “Se mjaft në robëri, / Kosovë e Çamëri, / O djem, rrëmbeni pushkët, / Ja vdekje, ja liri!” Demonstruesit kaluan nëpër shumë rrugë të qytetit me flamurin në ballë dhe demonstratën e 6

tetorit e përfunduan afër mesnatës, me vendosjen e flamurit tonë në oborrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nuk ka pasur ndërhyrje nga policia, ndonëse pritej. Organizuesit, Merimani, Pashku, Simoni e Gjergji, janë arrestuar dhe janë dënuar për kundërvajtje, si dhe janë hapur hetimet disamujore për ta, për vepra penale, në Prokurorinë e Prizrenit. Ishte kjo demonstrata e parë në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, me rreth tre mijë pjesëmarrës, për të drejta e liri kombëtare, në Prizren, në kryeqytetin historik shqiptar të Rilindjes. Ajo hapi rrugë për demonstrata në tërë Rrafshin e Dukagjinit, Rrafshin e Kosovës, Llapin, Gallapin, Moravën e deri në Pollog e Ulqin. Shih: Meriman Braha, “Demonstrata e Prizrenit më 6 tetor 1968”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 57- 76.

¹⁸ Studenti i Grupit të Prizrenit, Haxhi Bajraktari, mori përsipër organizimin e Demonstratës së Therandës, më 8 tetor 1968, dhe pos ndihmës nga ky grup, Merimani, Isa, Zymeri, Pashku e vëllezërit Kuzhnini, në Therandë i ndihmuan, sipas tij: Isak Bajraktari, drejtor, Osman Gega, Miftar Bajraktari, Rrahman Kryeziu, Veli Gashi me tre djemtë e tij, Musli Elshani, Nezir Gashi, Shaip Gashi, Isuf Avdyl Fetiu, Rexhep Brahim Gashi, Hysen e Arif Kabashi etj. Kërkesat në këtë demonstratë ishin si ato në Prizren - për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje, po edhe për universitet, krahas këndimit të këngëve atdhetare të ndaluara dhe të brohoritjeve për flamurin kombëtar. Ky organizim dallohet edhe për flamurin, shqiponjën e të cilit Haxhiu e vizatoi dhe e mbushi me tush të zi. Fat i madh është që ai flamur ruhet edhe sot në familjen e tij. (Shih: Haxhi Bajraktari, “Si u organizua Demonstrata e 8 tetorit 1968 në Therandë”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 77-82.

¹⁹ Studenti i Grupit të Prizrenit, Zymer Neziri, mori përsipër organizimin e Demonstratës së Pejës, më 19 tetor 1968, me ndihmën e Isa Demajt. Në Grupin e Pejës 1968 bënë pjesë edhe Ramadan Blakaj e Xhemajl Gashi. Ata formuan grupe veprimi në qytet, në shkollat e mesme – të Normales, Ekonomikut, Gjimnazit, Shkollës së Lartë Komerciale etj. që vepruan me shumë kujdes, larg syve të pushtetit, dhe me shumë guxim, në grupe e nëngrupe, në Pejë me rrethina. U dallua Grupi i Normales, shkollë që kishte rreth 700 nxënës shqiptarë: Miftar Tishuku, Demë Mulliqi, Rexhep Ferizi, Sylë Kuçi, Sadik Binaku, si dhe nëngrupet e tyre, nga u nis demonstrata. Po ashtu u dallua edhe Grupi i Kapeshnicës, për përgatitjen e shenjave identifikuese, kuqezi: rrobaqepësit Ali Azem Lajçi e Rexhep Berisha dhe Emine Neziri, nxënëse; Grupi i Flamurit: studentët e Prizrenit, Salajdin Braha e Murat Gorani, dhe Sadri Kelmendi, arsimtar i Normales. Pa këta e pa Isën, Xhemajlin e Ramadanin dhe familjet e tyre, pa Riza Smakën, student, Tafë Shalën, grupin e vajzave të Normales dhe profesorët e tyre, Bajram Ahmetgjekaj e Nagihane Basha, Peja ‘68 nuk do ta kishte madhështinë e organizimit dhe të pjesëmarrjes. Udhëheqja e qytetit - kryetari i Komunës së Pejës, kryetari i Komitetit të Lidhjes së Komunistëve, kryetari i Lidhjes Socialiste, kryetari i Komitetit të Lidhjes së Rinisë etj., në krye të qytetit, pikërisht në oborrin e Gjimnazit, kanë tentuar për t’i ndalur demonstruesit, por askush nuk i kishte përfillur, kurse policia ishte përpjekur t’i pengonte edhe gjimnazistët e rrethuar, që kishin thyer dritaret dhe i ishin bashkuar demonstratës. Në këtë demonstratë morën pjesë rreth shtatë mijë demonstrues, nxënës, studentë, bujq e zejtarë, të renditur pas flamurit kuqezi, i porositur në Kukës. Nga ajo dolën kërkesat e guximshme për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje. Me këngë atdhetare, kryesisht të ndaluara, dhe me broho-

tetor. Ky grup i studentëve të Prizrenit kishte lidhje me organizimin e demonstratave edhe me një grup tjetër në Prishtinë, por që është ende i panjohur. Lidhjen e mbante studenti i grupit të Prizrenit, Isa Demaj.²⁰

ritje të fuqishme për flamurin e popullin shqiptar, Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Shqipërinë, Abdyl Frashërin e Haxhi Zekën, Dedë Gjon Lulin e të tjerë, pjesëmarrësit demonstuan disa orë nëpër qytet, duke brohoritur edhe gjatë leximit të kërkesave para Kuvendit të Komunës, nga normalisti Sylë Kuçi, që i kishte hartuar Zymer Neziri. Më vonë, policia, pa uniforma, ka tentuar tinëzisht marrjen e flamurit te stacioni i trenit, por ajo është larguar pas krismës me armë të grupit që ishte për mbrojtjen e flamurit. Nuk ka pasur dhunë nga ana e tyre, ndonëse pritej. Dhunë pritej edhe nga popullsia sllave e qytetit, që ishin një shumicë tejet e madhe, përndryshe, mund të kishte edhe gjakderdhje atë ditë të tregut të madh në Pejë. Kanë ndihmuar në organizim me këshilla, brezi i NDSH-së dhe Sylë Mehmeti, si dhe Nezir Gashi me shokë nga brezi i Adem Demaçit. Për organizuesit e Demonstratës së 19 tetorit '68 pati arrestime, dënime me burg për kundërvajtje, hapje hetimesh disamujore për vepra penale në Prokurorinë e Pejës (Zymeri, Ramadani e Xhemajli), përjashtime të nxënësve nga Normalja, diferencime politike, përjashtime nga Partia etj. Me Pejën '68 u mbyll suksesshëm plani i Grupit të Prizrenit për demonstratat e tetorit në Rrafshin e Dukagjinit. Më hollësisht, shih edhe: Demë Mulliqi, "Rrjedha e demonstratave të 68-ës në Pejë", në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 83-92; Sylë Kuçi, "Historia e një vjeshte", *po aty*, vëll. II, f. 231-238; Shkodran Imeraj, "Kontributi i të rinjve nga Komuna e Deçanit në Demonstratën e vitit 1968 në Pejë", *po aty*, vëll. II, f. 245-253.

²⁰ Grup i Prishtinës, që ishte në lidhje me Grupin e Prizrenit, nuk e përfundoi punën e nisur dhe u tërhoq për shkak të pasigurisë, sipas Isa Demajt, kurse organizimin dhe realizimin e kreu guximshëm grupi tjetër i Prishtinës, me në krye Osman Dumoshin, më 27 nëntor 1968, tashmë i njohur në historinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Plan i grupit të Prishtinës për organizimin e demonstratave, pos kryeqytetit, përfshinte edhe Ferizajn, me anën e poshtme të Rrafshit të Kosovës, Gjilanin me krahinën e Anamoravës, si dhe Besianën me krahinat Llap e Gallap. Grupin e Prishtinës e dënuan më 7 prill 1869 në Gjyqin e qarkut të Prishtinës: Osman Dumoshi, Adil Pireva, Selatin Novosella, Hasan Dërmaku, me nga pesë vjet burg; Skënder Kastrati, Xheladin Rekalii, me nga 4 vjet burg; Afrim Loxha, Ilaz Pireva, Skënder Muçolli, me nga 3 vjet burg. Në këtë demonstratë të madhe e të përgjakshme në Prishtinë ra dëshmor Murat Mehmeti, nxënës i Shkollës së Mesme Teknike. Janë plagosur, sipas Sami Dërmakut: Bajram Grajçevci, Irfan Rushiti, Shefki Osmani, Skënder Muçolli, Miftar Krasniqi, Mejreme Berisha, Haxhi Lahu, Gani Gashi, Sylejman Zhivina, Avdi Jahiri, Haxhi Shabani, Xheladin Kuçi, Hilmije Krasniqi, Hajriz Maliqi, po edhe Isa Demaj e të tjerë, që nuk dihen, se janë shëruar fshehurazi, për të mos u diktuar nga policia. Kjo demonstratë e studentëve dhe e intelektualëve, e rinisë dhe e punëtorëve, e bujqve dhe e zejtarëve, kishte kërkesa para pushtetit jugosllav, të cilat i hartuan Adil Pireva e Osman Dumoshi dhe i lexuan Osman Dumoshi e Skënder Kastrati, para Teatrit Kombëtar. Parullat kryesore në këtë demonstratë për Republikën e Kosovës ishin: "Duam vetëvendosje deri në shkëputje!", "Duam kushtetutë!", "Duam bashkimin e viseve të banuara me shqiptarë me Kosovën!" etj. Shih: Selatin Novosella, "Republika

Demonstratat vijuese janë mbajtur në nëntor, në qytetet Prishtinë, Gjilan²¹, Ferizaj²² dhe Besianë (Podujevë)²³, të zhvilluara më 27 nëntor të atij viti dhe të organizuara mirë e guximshëm nga grupi i njohur i Prishtinës. Nxitje dhe shtytje i kishte dhënë këtij organizimi edhe përfundimi shumë i suksesshëm i planit të Grupit të Prizrenit²⁴ me

e Kosovës, në vitin 1968, ishte imperativ i kohës”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 47-54; Sami Dërmaku, “Dhuna dhe gënjeshtria nuk luftojnë me njëra-tjetrën, ato mbysin njerëz të pafajshëm”, *po aty*, vëll. I, f. 93-98.

²¹ Në Gjilan, në këtë qendër të njohur të Anamoravës, më 27 nëntor, në krye të organizimit, sipas Selatin Novosellës, ishin: Irfan Shaqiri, Rexhep Mala, Xhavit Dërmaku, Vahide Braha, Fetije Bajrami, Ahmet Hoti, Mynivere Kastrati, Atdhe Salihu, kurse koordinues nga Grupi i Prishtinës ishin studentët Asllan Kastrati dhe Beqir Qerimi. Brohoritjet e demonstruesve edhe në Gjilan ishin si ato në qytetet e tjera, për Vetëvendosje, Kushtetutë e Republikë. Pati arrestime dhe dënime për kundërvatje, kurse Irfan Shaqirin e dënuan me 11 muaj burg. Shih: S. Novosella, “Republika e Kosovës, në vitin 1968 ...”, f. 113-119.

²² Edhe në Ferizaj, në këtë qendër të madhe të Rrafshit të Kosovës dhe të veprimtarisë atdhetare, më 27 nëntor, u demonstrua me parullat për Vetëvendosje, Kushtetutë e Republikë. Ali Mehmeti kishte përgatitur referatin, të cilin, para Kuvendit Komunal, e lexoi studenti Ismet Ramadani, ku ndërhyri edhe policia dhe zjarrfikësit, por demonstratat nuk u ndërprejnë. Pati dënime, deri në 12 muaj burg, për veprimtarët: Ali Mehmeti, Ismet Ramadani e Hasan Abazi, si dhe deri në 1 muaj burg: Beqir Beqiri, Avdullah Zymberi, Muhamet Sylejmani, Mehmet Emërllahu, Sylejman Bytyçi, Hasan Muhaxheri, Ekrem Beqiri. Ali Mehmeti e vuajti dënimin në burgun famëkeq “Goli Otok”. Shih: Ali Mehmeti, “Demonstratat e vitit 1968, vazhdimësi e lëvizjes shqiptare të Kosovës”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 107-113.

²³ Në organizimin e Demonstratave në Besianë, më 27 nëntor, sipas Hakif Shehollit, kanë marrë pjesë: Xheladin Rekalii, nga Trupi Koordinues i Prishtinës, Hamit Abdullahu, Sabit Syla, Hakif Sheholli, Bahri Shabani, Xhafer Ejupi, Hasan Shala, Skënder Hoxha, Shaqir Shala. Ky brez i Llapit e i Gallapit liridashës dhe pasardhës i brezit të Adem Demaçit, me këngë atdhetare doli në rrugë me parullat për Vetëvendosje, Republikë e Kushtetutë. Sabit Syla, para hotelit “Llap” lexoi fjalimin dhe tha se shqiptarët nuk kanë liri të plotë, duke theksuar me vendosmëri se: “Për të drejtat tona do të derdhim gjak!” Pati arrestime e dënime me burg, nga 1 muaj deri në 4 vjet. Shih: Hakif Sheholli, “Demonstratat e 68-tës në Podujevë”, në *Demonstratat e vitit 1968...*, vëll. I, f. 99-106.

²⁴ Shih: **Deklarata e Osman Dumoshit**, para organeve të Punëve të Brendshme për Demonstratën e mbajtur në Prishtinë, më 27 nëntor 1968, dhënë më 28.11.1968: “Mbas demonstratave të Prizrenit, Suharekës, Pejës etj. u komentojshin në mesin e studentëve dhe të tanë qytetarëve. Fill mbasi muarëm vesh me anë të radios, shtypit dhe bisedimeve nëpër rrugë, edhe unë një ditë, mbasandej, në shoqni i komentojshim këto ngjarje. Mbas komentimit, ashtu spontanisht, unë me shokët Afrim Loxha, Skënder Berisha, Skënder Muçolli, e s’më kujtohet a ka qenë me ne atë ditë ndokush tjetër, lindi ideja që edhe ne studentët e Prishtinës të mbajmë një manifestim. Kështu

demonstratat dyjavore të tetorit 1968 në Rrafshin e Dukagjinit.²⁵ Demonstrata janë organizuar, në mënyrë të pavarur dhe janë mbajtur edhe në Mitrovicë²⁶, Tetovë²⁷ dhe Ulqin.²⁸

që prej atij momenti ia kemi filluar me bisedu dhe me shokët, kolegët e fakultetit tonë.” Shih: Meriman Braha, *Demonstratat e vitit 1968* (dorëshkrim), Prishtinë: 2008, kreu “Dokumente nga Arkivi i Kosovës - Prishtinë, për Demonstratat e vitit 1968”.

Shih edhe deklaratën tjetër të Osman Dumoshit, para Trupit Gjykues, kryesuar nga Nazmi Juniku, dhënë më 2.6.1968, në procesverbalin e mbajtur më 4.12.1968: “...Pastaj, sikurse dihet kanë ndodhë disa ngjarje në disa vende të Krahinës, si në Pejë etj. Dhe në bisedat që unë kam pasur me të pandehurit të tjerë kemi filluar të mendojmë që edhe ne në Prishtinë të organizojmë një lloj manifestimi e këtë ta bëjmë në natën e 28 nëntorit me disa kërkesa reale, që sipas mendimit tim nuk kanë pasur asnjë karakter të kundërt me vijën e LKJ.” Shih: *po aty*.

²⁵ **Deklarata e Afrim Loxhës**, dhënë para gjykatësit hetues, Riza Fazlija, më 29.11.1968, në Prishtinë: “Pas demonstratave të zhvilluara në Pejë, tek unë është zhvilluar ideja, që ne, studentët e Prishtinës, do të mund të bënim demonstrata të tilla.” Shih: *po aty*.

Për ndikimin që patën Demonstratat e Rrafshit të Dukagjinit (1968) në grupin e organizimit të Demonstratave të Prishtinës (1968), shih deklaratat vijuese:

Deklarata e Skënder Muçollit, dhënë para gjykatësit hetues Riza Fazlija, më 1.12.1968: “...Pas demonstratave të mbajtura në Prizren, Suharekë dhe Pejë, në të cilat unë nuk kam marrë pjesë, gjatë shëtitjeve me shokët e përmendur është zhvilluar biseda rreth asaj se edhe ne në Prishtinë duhet të organizojmë demonstrata të tilla.” Shih: *po aty*.

Deklarata e Iljaz Pirevës, dhënë para gjykatësit hetues, Riza Fazlija, më 27.12.1968: “Edhe pse për mua personalisht demonstratat e Pejës dhe të disa vendeve tjera nuk kanë qenë të ndonjë rëndësie të veçantë dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt, më duket se bisedat për demonstratat në Prishtinë janë zhvilluar pas demonstratës së Pejës dhe kurrsesi më parë”. Shih: *po aty*.

²⁶ Këshilli Organizues i Demonstratave të vitit 1968 në Mitrovicë, sipas Latif Zariqit, përbëhej nga: Nebih Istogu, Latif Zariqi, Mustafë Shyti, Naim Bujupi, Vesel Demaku, Ramadan Bytyçi, Mustafë Zariqi. Më 27 nëntor demonstruesit janë nisur nga shkolla e mesme normale “Hasan Prishtina” dhe kanë vazhduar në drejtim të qendrës, me kërkesat për flamurin e lirë kombëtar, për hapjen e universitetit, për Kosovën Republikë dhe për Vetëvendosje. Këtë demonstratë e ka përkrahur me guxim e vendosmëri edhe drejtori i Normales, Ahmet Maloku. Shih: Latif Zariqi, “Organizimi i Demonstratave të vitit 1968 në Mitrovicë, në *Demonstratat e vitit 1968* ..., vëll. I, f. 115-120.

²⁷ Demonstratat e Tetovës, më 22-23 dhjetor 1968, sipas Faik Mustafës, ishin për barazinë kombëtare e kundër nacional-shovinizmit maqedonas, për flamurin kuqezi e simbolet kombëtare të ndaluara, për gjuhën shqipe të nëpërkëmbur e për historinë, traditën e kulturën. Më të merituarit e Tetovës ‘68, sipas tij, ishte grupi i 15-shes: që kishte 11 studentë, dy prej tyre ishin nga Gjakova, Agim Jaka e Ibrahim Rudi. Janë arrestuar: Memetriza Murtezani-Gega, Faik Mustafa, Ramadan Sinani, Femi Rufati, Harun Jakupi, Mamut Bajraktari, Salajdin e Fahredin Hyseini, Abdulla Kalishta,

Demonstratat për Republikë, Kushtetutë e Vetëvendosje kanë qenë disamujore në Kosovë dhe në viset shqiptare të ripushtuara nga Jugosllavia. Ato u shuan me gjak, pati shumë të lënduar e të plagosur, ra dëshmor nxënësi i Shkollës së Mesme Teknike në Prishtinë, Murat Mehmeti. Organizuesit u dënuan me burg. Pati shumë dënime me përjashtime nga puna dhe ndjekje politike të vazhdueshme. Por, edhe dyert për ndryshime ishin hapur,²⁹ mirëpo rezultatet nuk qenë të plota.³⁰ Përpjekjet vazhduan edhe më 1981, më 1989 dhe deri në formimin dhe luftën e tri ushtrive çlirimtare, 1997-2001.

Republika dhe bashkimi kombëtar

Çështja e Republikës së Kosovës, e Republikës Shqiptare në Jugosllavi dhe e bashkimit kombëtar janë shtruar shumë herë, me pak a më shumë ndryshime, në kuadër të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare në ish Jugosllavi.

Nexhbedin Neziri, Jakup Leka, Abdylaziz Abdiu, Abdylmenaf Rrustemi, Ismailhaki Emini, Beqir Berisha, Hysniqemal Sherifi etj., të cilët u dënuan nga 1 deri 7 vjet burg. Mbi 1 000 të tjerë i dënuan për kundërvajtje deri në 60 ditë burg. Pati arrestime e dënime me burg edhe në Gostivar, në Kërçovë e në Strugë, - ka thënë ai. Jehona e tyre ishte e madhe. Ato ishin hallkë e re në historinë e përpjekjeve të këtyre viseve shqiptare për vazhdimin e forcimit të ndjenjave kombëtare dhe për realizimin e idealeve për liri e bashkim. Shih: Faik Mustafa, “Demonstratat e 68-s - lëvizje e shqiptarëve në Maqedoni”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 121-126.

²⁸ Rreth 400 pjesëmarrës, sipas Bahri Briskut, kanë demonstruar në Ulqin, në vazhdimësinë e demonstratave në Kosovë e Maqedoni, kanë kënduar këngë atdhetare dhe kanë brohoritur: “Duam liri dhe barazi!”, “Duam liri-duam liri, jemi Shqipëri-jemi Shqipëri!”, “Rroftë Kosova heroike!”, “Rroftë trimi shqiptar Skënderbeu!”, “Rroftë Shqipëria dhe Enver Hoxha!” etj. Policia ka arrestuar dhe ka ndjekur penalisht gazetarin Bahri Brisku dhe ka dënuar 85 prindër me shuma të mëdha të hollash, të tjerët i ka përjashtuar nga puna e Partia. Sipas tij, trupi organizues i Demonstratave të Ulqinit 1968, më 3 qershor, për liri, për Shqipërinë e për Kosovën, ishin: Elez Nikeziqi, Bahri Brisku, Bajram Sela, Hasan Bojku, Selatin Bajraktari, Qemal Dervishi, Avdyl Murati, Caf Shkodrani, Esat Hoxha, Fadil Brisku, Lekë Vukmarkoviqi, Ruzhdi Alibegu, Naxhije Alibegu, Medete Brisku, Nikë Marnika, Ali Murati. Shih: Bahri Brisku, “Gjendja politike pas Demonstratave të Ulqinit, me 3 qershor 1969”, në *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 191-206.

²⁹ Klasa politike shqiptare, shumica, me në krye Fadil Hoxhën, nuk ishte gati për Republikën e Kosovës, sepse u rirreshtua me Beogradin dhe ishte kundër kësaj kërkesë “armiçësore”, siç e quante Serbia e Jugosllavia.

³⁰ Edhe një pjesë e intelektualëve të kohës nuk mbajti qëndrim kombëtar ndaj kërkesave të Demonstratave të vitit 1968.

Shaban Braha, pas një analize të thelluar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, të kërkesave për Republikë e Vetëvendosje, si fazë kaluese deri te bashkimi, në veprën e tij të njohur *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990*, konstaton me shumë të drejtë se: “Duke u ndodhur në vazhdim të gjendjes së mëparshme, populli i Kosovës dhe veçanërisht brezi i ri në Kosovë po përpunonte strategjinë e çështjes kombëtare, të unifikimit të kombit në varësi me kushtet në evoluim.”³¹

Ukshin Hoti e shihte Republikën e Kosovës vetëm në funksion të bashkimit dhe të forcimit të raporteve të reja në gjithë territorin e Ballkanit, të Mesdheut dhe të Evropës: “Republika e Kosovës, me fjalë të tjera, pavarësisht nga ajo se kush mund jetë në nivelin institucional bartës i një politike gjithëshqiptare, në rrethanat e dhëna është realizim i njërit prej interesave vitale të kombit. Si e tillë, mund të qëndrojë vetëm në funksion të bashkimit por edhe të forcimit të raporteve të reja në gjithë territorin e Ballkanit, të Mesdheut dhe të Evropës. Këtë rol mund t'a luajë me sukses në kontekst të proceseve integrative të Evropës, që do të kenë konsiderata për të gjithë pjesëmarrësit dhe për gjithë drejtimin historik të zhvillimit të proceseve pozitive”.³²

Duke shkruar për përcaktimin e tij për Republikën e barabartë sovraane të Kosovës, ai flet edhe për vënien e Republikës së Kosovës në funksion të bashkimit të kombit.³³ Republika e Kosovës, sipas tij, por edhe shqiptarët në përgjithësi, duhet t'i nderojnë sidomos vlerat e gjakut të derdhur të bijve të vet.³⁴

³¹ Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990*, Gjakovë: Lumi-T, 1991, f. 504.

³² Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, zgjedhi dhe redaktoi Bislim Elshani, Tiranë: Rozafa, 1995, f. 59.

³³ *Po aty*, f. 104. “Përcaktimi im për Republikën e barabartë sovraane të Kosovës, për statusin e bartësit të shtetësisë së sanksionuar me kushtetutë në Republikën e Maqedonisë, dhe për garancionet evropiane të të drejtave të shqiptarëve në Republikën e Malit të Zi, pastaj për vënien e Republikës së Kosovës në funksion të bashkimit të kombit, paralelisht me zhvillimin e proceseve integrative në Evropë, mund të vihej në suaza të botëkuptimeve legaliste dhe të rrugëve të matura.”

³⁴ *Po aty*. “Ndërkaq, për sa i përkiste popullit shqiptar, ai gjatë historisë së vet të mundimshme nuk ishte pajtuar kurrë ndonjëherë me kurrfarë forme të tiranisë as me hegjemoninë dhe as me fashizmin. Republika e Kosovës, por edhe shqiptarët në përgjithësi, as nuk mundnin dhe as që dëshironin t'i injoronin vlerat e gjakut të derdhur të bijve të vet. Ajo do t'i nderonte dhe do t'u bënte homazhe kufomave të tyre në nivelin e dinjitetit që i takonte si Republikë.”

Ndërkaq, Ethem Çeku, në veprën e tij me interes *Mendimi politik i ilegales në Kosovë 1945-1981*, thotë se Demonstratat e vitit 1968 “i kishin dhënë fund një lufte ilegale efektive me parulla dhe propagandë, në të gjitha nivelet”.³⁵

Me rëndësi të veçantë janë edhe konstatimet e prof. Rexhep Qosjes, në fillim të viteve '90, në veprën e njohur *Strategjia e bashkimit kombëtar*, për Republikën e Kosovës, për Republikën Shqiptare në Jugosllavi dhe për bashkimin kombëtar. Republikën e Kosovës e konsideronte “zgjidhje politike, por nuk thoshte se është edhe zgjidhje politike e çështjes shqiptare në Jugosllavi”.³⁶ Republikën Shqiptare në Jugosllavi e konsideronte “zgjidhje më të plotë të çështjes, por as këtë nuk e quan zgjidhje përfundimtare”,³⁷ kurse për bashkimin kombëtar thotë se “kjo ishte e vetmja zgjidhje e drejtë dhe e vetmja zgjidhje e përhershme e çështjes shqiptare”.³⁸

Përfundime

Viti 1968 i Demonstratave për Kushtetutë, Republikë e Vetëvendosje, si fazë kaluese drejt bashkimit kombëtar, lidhet me kohën kur tre milion shqiptarë jetonin nën sovranitetin e Serbisë, të Maqedonisë e të Malit të Zi.³⁹

Brezi i demonstruesve të viteve '68 u lind me kryengritjen shqiptare pas ripushtimit jugosllav të Kosovës e të viseve shqiptare, me tragjedinë e Tivarit, me plaçkitjen e shqiptarëve në emër të tepricave; u rrit me ndalimin e flamurit kombëtar, pa të drejtë gjuhe në administratë, me ndjekjet, burgosjet e pushkatimet e pjesëtarëve të NDSH-së; e kaloi fëmijërinë në kohën e aksionit famëkeq të mbledhjes së armëve; e përjetoi dramën kolektive të shpërnguljes në Turqi dhe tronditjen kombëtare të pushkatimit të burrave në kufi; u bë pjesë e traumës gjithëpopullore të burgosjeve të atdhetarëve të brezit të viteve '50.

³⁵ Ethem Çeku, *Mendimi politik i ilegales në Kosovë 1945-1981*, Prishtinë: Brezi '81, 2003, f. 175.

³⁶ Rexhep Qosja, *Strategjia e bashkimit kombëtar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 1992, f. 103.

³⁷ *Po aty*, f. 105.

³⁸ *Po aty*, f. 107.

³⁹ Viti 1968 ishte vit i kërkesës për barazi me popullin që kishte 4-5 herë më pak popullsi se shqiptarët (Mali i Zi) dhe, kur kjo e drejtë iu dha popullit pa identitet të formësuar (Maqedoni), përgjysmë më i vogël se populli shqiptar.

Brezi i demonstruesve të viteve '68 e kaloi moshën e miturisë dhe iu bë krah brezit të viteve '60 të Adem Demaçit, duke shpërndarë flamurin kombëtar, të ndaluar me ligj; duke lexuar literaturën e ndaluar, sidomos *Shqipërinë* e Samiut dhe *Lahutën* e Fishtës; duke e dëgjuar fshehurazi Radio Tiranën; duke kënduar këngë atdhetare, po ashtu të ndaluara nga pushteti jugosllav; duke e adhuruar Skënderbeun dhe heronjtë e historisë, nga periudha ilire e deri te Rilindja Kombëtare, por edhe më vonë, duke shkruar shumë shpesh në mure parullën “Rrnoftë Shqipnija” dhe duke u krenuar se jemi shqiptarë.

Viti 1968 i Demonstratave për Kushtetutë, Republikë e Vetëvendosje dallohet si vit i ngritjes së vetëdijes kombëtare për çlirim dhe njihet si hallkë historike e *Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* për bashkimin e kombit të ndarë, në kohën organizimit dhe të shënimit të përvjetorëve të mëdhenj kombëtarë: 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, 90-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 60-vjetori i Kongresit të Manastirit; mbajtja e Konsultës Gjuhësore në Prishtinë, paraprijëse e Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë.

Brezi i demonstruesve të viteve '68 ishte i lumtur vetëm për pak çaste kur klasa politike e Kosovës me ata pak intelektualë të asaj kohe kërkonin Kushtetutë, Republikë e Vetëvendosje, duke i përkrahur kërkesat mbarëpopullore, por u dëshpërua kur ata hoqën dorë nga kërkesat legjitime të popullit të tyre. Ky brez mori në duart e veta fatin e Kosovës dhe u bë gati që botërisht t'i thuhej ndal pushtetit jugosllav.

Brezi i demonstruesve të viteve '68 shënon edhe fillimin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, e cila ishte burgu kolektiv i shqiptarëve, të dënuar me qindra shekuj me burg politik, që u mbyll pas luftës fitimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Viti 1968 i Demonstratave për Kushtetutë, Republikë e Vetëvendosje ishte vit kur çështja e pazgjidhur kombëtare e shqiptarëve u shtrua guximshëm edhe në rrugë, me demonstrata të mëdha e të përgjakshme, si pasqyrim i vullnetit të së drejtës kombëtare dhe universale të bashkimit të popujve të ndarë. Ky vit konsiderohet shumë i rëndësishëm edhe për ndërkombëtarizimin e çështjes së pazgjidhur kombëtare shqiptare në qarqet politike dhe intelektuale evropiane e botërore dhe hallkë e re e fillimit të organizimit të kryengritjes së armatosur në vitet '90 dhe të luftës së tri ushtrive çlirimtare.⁴⁰

⁴⁰ *Demonstratat e vitit 1968 ...*, vëll. I, f. 37- 46.